

To: sabina\_veizaj@hotmail.com;  
Cc: zyraeshtypit dpt;  
Bcc: xhavit curri;

Kthim pergjigje kerkeses per informacion

Pershendetje Zj. Veizaj

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar elektronikisht në adresën e Zyrës së Shtypit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit, regjistruar me nr. 146 në regjistrin e kërkesave dhe Përgjigjeve, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju informojmë si më poshtëvijon:

### **Sa biznese të vogla dhe të mesme kanë falimentuar, janë cregjistruar dhe janë me status pasiv nga 2013- tani?**

Tabela e mëposhtme paraqet informacionin e kërkuar, në mënyrën si administrohet ky informacion nga DPT:

<b>Viti</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>	<b>2018</b>	<b>deri tetor 2019</b>
<b>Pasive</b>	8,198	36,694	6,026	29,004	12,886	15,524	9,358
<b>Cregjistrime</b>	3,613	4,100	5,349	6,625	3,557	3,425	2,173

### **Si do të funksionojë konkretisht procesi i fiskalizimit?**

Fiskalizimi është një tërësi masash të cilat do të mundësojnë raportimin në kohë reale të informacionit në Administratën Tatimore. Tatimpaguesit të cilët do të lëshojnë fatura do të duhet ti raportojnë ato në kohë reale. Për këtë, subjektet që do të nënshtrohen këtij procesi duhet të pajisen me një certifikatë digjitale për nënshkrimin elektronik të faturave, të sigurojnë një pajisje fiskale dhe zgjidhje softuerike e cila lëshon dhe dërgon fatura elektronike si dhe të kenë një lidhje me internet. Në këtë mënyrë, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit do të raportohet në momentin kur kryhe dhe jo në fund të ditës.

### **Vecanërisht për biznesin e vogël?**

Biznesi i vogël do të ketë procedurë të thjeshtëzuar për kryerjen e procesit të fiskalizimit. Tatimpaguesve të kësaj kategorie do t’u krijohet mundësia që ti fiskalizojnë faturat e tyre elektronike nëpërmjet portalit qendror të shkëmbimit të faturave. Për këtë biznesit të vogël do ti duhet të ketë një certifikatë digjitale për nënshkrimin elektronik, lidhje me internet dhe një pajisje e cila mund të lidhet me portalin për lëshimin dhe dërgimin e faturave. Gjithashtu, aktualisht po punohet me mundësinë që pajisjet fiskale aktuale të përshtaten, gjë e cila do të rezultojë në një lehtësirë për tatimpaguesit, veçanërisht për biznesin e vogël.

### **Cfarë kostosh shtesë do të ketë? / Sa do të kushtojë softueri dhe printeri?**

Ofrimi i zgjidhjeve softuerike do të funksionojë në bazë të një tregu të hapur. Administrata Tatimore do të ketë rol menaxhues dhe administrues të subjekteve të cilat do të certifikohen dhe do të plotësojnë kriteret teknike të kërkuara në sajë të funksionimit të procesit të fiskalizimit dhe raportimit të të dhënave. Aktualisht kompanitë e interesuara janë në fazë

testimi dhe përshtatjeje të zgjidhjeve të tyre softuerike në përputhje me specifikimet teknike të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

### **A do të ketë trajnime për biznesin?**

Administrata Tatimore ka nisur ciklin e parë të trajnimeve mbi projektin e Fiskalizimit, duke filluar me Trajnimin e trajnerëve rajonalë, specialistë me përvojë, të përzgjedhur nga secila prej Drejtorive Rajonale Tatimore.

Kjo është vetëm faza e parë e një cikli të gjerë trajnimesh, i cili përveç stafit të Administratës Tatimore, përfshin edhe trajnimin e tatimpaguesve dhe specialistëve të fushës në lidhje me këtë projekt. Trajnimet do të shtrihen në të gjithë vendin dhe do të organizohen në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore(QTATD), duke përcjellë njohuritë e nevojshme mbi të gjitha fazat dhe modalitetet e zbatimit të këtij projekti.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Punë të mbarë

**Hermelinda Hysenaj**  
**Specialiste e Sektorit të Asistencës dhe Sherbimit**  
**Drejtoria e Sherbimit ndaj Tatimpaguesve**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**  
**Tel Office: 04 2276 840**  
**Web: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)**